



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, nenit 8 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.011-43473 e datës 28.06.2019, si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008, duke vendosur sipas kërkesës Nr.1-400-23413 të datës 12.05.2021 të Shoqatës së OMPAKU dega në Lipjan, Kryetari i Komunes nxjerr:

VENDIM PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE

Neni 1

I ndahet shuma e mjeteve në vlerë prej 490 € (katërqind e nëntëdhjetë euro), Shoqatës së OMPAK-ut dega në Lipjan, sipas kërkesës së tyre Nr.1-400-23413 të datës 12.05.2021, për realizimin e nevojave të ndryshme financiare në mënyrë që të funksionojnë si zyre pune për aktivitet e tyre gjatë vitit 2021.

Neni 2

Shuma e cekur nga neni 1 do të paguhet nga mjetet e buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitin 2021 pozicioni buxhetor- subvencionet e planifikuara për Zyrën e Kryetarit të Komunës në xhirollogarinë bankare të Shoqatës së OMPAK-ut dega në Lipjan, në nr. 1907946619031150 në BKT bankë.

Neni 3

Lidhur me mjetet e shpenzuara e lartëcekura duhet të sjell dëshmi-faturë deri në shumën e lejuar dhe të njëjtat ti dorëzojë në Sektorin për përfaqësim dhe çështje ligjore më së largu me datë 25.12.2021.

Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Zyra e Kryetarit të Komunës dhe Drejtorati për Buxhet dhe Financa.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Shoqata OMPAK-ut dega në Lipjan.

1Nr.400-23413

Lipjan, më 14.05.2021

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti

